<p>2.Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në kërkesën për kualifikim, secili anëtar i një konzorciumi mund të marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vetëm në një konzorcium në të njëjtën kohë. Shkelja e kësaj rregulle rezulton me përjashtimin e konzorciumit dhe të anëtarit individual.</p> <p>3. Gjatë shqyrtimit të kualifikimeve të Konzorciumeve ofertuese, Autoriteti Kontraktues merr parasysh aftësinë dhe shkallën e pjesëmarrjes të secilit anëtar të konzorciumit dhe vlerëson nëse kualifikimet e kombinuara të anëtarëve të konzorciumit janë të përshtatshme për përmbushjen e nevojave të të gjitha fazave të projektit. Autoriteti Kontraktues mund të specifikojë kriteret minimale për pjesëmarrje të anëtarëve kryesor të konzorciumit të cilat konsiderohen esenciale për plotësimin e kushteve të kualifikimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 29</p> <p style="text-align: center;">Vendimi mbi para-përzgjedhjen</p>	<p>2. Osim ako je drugačije navedeno u zahtevu za kvalifikacije, svaki član konzorcijuma može učestvovati, direktno ili indirektno, samo u jednom konzorcijumu u isto vreme. Kršenje ovog pravila će dovesti do diskvalifikacije konzorcijuma i člana pojedinca .</p> <p>3. Prilikom razmatranja kvalifikacije ponuđačkih konzorcijuma, Ugovorni autoritet će razmotriti sposobnosti i deo učešćaza svakog člana konzorcijuma i proceniti da li su kombinovane kvalifikacije članova konzorcijuma dovoljne za ispunjenje potreba svih faza projekta. Kontraktuelni autorite može specificirati minimalne kriterijume za učešće glavnih člana konzorcijuma koje se smatraju esencijalne za ispunjavanje uslova kvalifikacije.</p> <p style="text-align: center;">Član 29</p> <p style="text-align: center;">Odluka o izboru pred-selekcije</p>	<p>2.Unless otherwise stated in the request for qualification, each member of a consortium may participate, either directly or indirectly, in only one consortium at the same time. A violation of this rule shall cause the disqualification of the consortium and of the individual members.</p> <p>3. When considering the qualifications of bidding consortia, the Contracting Authority shall consider the capabilities and levels of participation of each of the consortium members and assess whether the combined qualifications of the consortium members are adequate to meet the needs of all phases of the project. The Contracting Authority may specify minimum participation levels for key consortium members that are deemed essential to meeting qualification requirements.</p> <p style="text-align: center;">Article 29</p> <p style="text-align: center;">Decision on pre-selection</p>
---	---	--



<p>Autoriteti Kontraktues merr vendim lidhur me kualifikimet e secilit ofertues i cili ka paraqitur aplikacionin për para-përzgjedhje. Gjatë marrjes së këtij vendimi, Autoriteti Kontraktues përdorë vetëm kriteret e përcaktuara në kërkesën për kualifikim. Të gjithë ofertuesit e para-përzgjedhur më pas ftohen nga Autoriteti Kontraktues për paraqitjen e propozimeve të tyre në përputhje sipas neneve 30 deri 39 të këtij ligji.</p>	<p>Ugovorni autoritet donosi odluku o kvalifikacijama svakog ponuđača koji je podneo zahtev za pred-selekciju. Prilikom donošenja te odluke, Ugovorni autoritet će koristiti samo kriterijume navedene u zahtevu za kvalifikacije. Svi selekcionirani ponuđači i će zatim biti pozvani od strane Ugovornog autoriteta da iznesu svoje predloge u skladu sa članovima članovima 30 do 39 ovog Zakona.</p>	<p>The Contracting Authority shall make a decision with respect to the qualifications of each Bidder that has submitted an application for pre-selection. In reaching that decision, the Contracting Authority shall apply only the criteria that are set forth in the request for qualification. All pre-selected Bidders shall thereafter be invited by the Contracting Authority to submit proposals in accordance with Articles 30 to 39 of this law.</p>
<p>KREU III</p>	<p>III POGLAVLJE</p>	<p>CHAPTER III</p>
<p>PROCEDURAT MBI KËRKESËN PËR PROPOZIME</p>	<p>PROCEDURE ZA TRAŽENJE PREDLOGA</p>	<p>PROCEDURES FOR REQUESTING PROPOSALS</p>
<p>Neni 30</p>	<p>Član 30</p>	<p>Article 30</p>
<p>Procedurat një-fazëshe dhe dy-fazëshe mbi kërkesën për propozime</p>	<p>Jedno-fazne i dvo-fazne procedure za traženje predloga</p>	<p>Single-stage and two-stage procedures for Solicited Proposals</p>
<p>1. Procedurat për kërkimin e propozimeve</p>	<p>1. Procedure za traženje predloga mogu se</p>	<p>1. The procedures for solicited proposal shall</p>



<p>mund të zhvillohen në 1 ose 2 faza.</p> <p>2. Kundrejt pagimit të cilësdo takse e cila mund të aplikohet ose caktohet, autoriteti kontraktues publikon kërkesën për propozime dhe do t'u sigurojë ofertuesve të para përzgjedhur një kërkesë për propozime në pajtim me nenin 28 të këtij ligji.</p> <p>3. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Autoriteti Kontraktues mund të zhvillojë një procedurë dyfazëshe mbi kërkesën për propozime nga ofertuesit e para-përzgjedhur, nëse elementet e projektit, si p.sh specifikimet e projektit, treguesit e performancës, aranzhimet financiare ose kushtet e kontratës nuk mund të përshkruhen në kërkesën për propozime në mënyrë mjaft të hollësishme ose të saktë për t'u mundësuar ofertuesve që t'i përgatisin propozimet e tyre përfundimtare.</p> <p>4. Kur përdoret procedura dy-fazëshe, zbatohen dispozitat në vijim:</p> <p>4.1.kërkesa fillestare për propozime duhet të kërkojë nga ofertuesit që në fazën e parë të procedurës të dorëzojnë propozimet e tyre fillestare lidhur me specifikimet e projektit, treguesit e performancës, kushtet financiare</p>	<p>razvijati na 1 ili 2 faze.</p> <p>2. Nasuprot plaćanja bilo koje takse koja se može primeniti ili odrediti, Ugovorni autoritet će objaviti zahtev za predloge i takođe obezbediti pre-kvalifikovanim ponuđačima zahtev za predloge u skladu sa članom 28. ovog zakona.</p> <p>3. Bez obzira na gorepomenuto, ugovorni autoritet može da razvije dvo- faznu proceduru za zahtevanje predloga od pred-selektiranih ponuđača, ako elementi projekta, kao npr. specificiranje projekta, indikatori performansi, finansijski aranžmane ili uslovi ugovora, ne mogu biti opisani u zahtevu za predloge, na detaljan i precizan način kako bi omogućilo ponuđačima da pripreme svoje konačne predloge</p> <p>4. Kada se koriste dvofazne procedure, primenjuju se sledeće odredbe:</p> <p>4.1.Prvobitni zahtev za predloge treba da zahteva od ponuđača da u prvoj fazi procede dostave svoje početne predloge u vezi sa specifikacijom projekta, indikatorom performanse, finansijskom stanju i</p>	<p>take place in 1 or 2 stages.</p> <p>2. Against payment of any fee that might be applied or assessed, the contracting authority shall publish a request for proposal and provide the pre-qualified bidders with a request for proposals in compliance with Article 31 of this law.</p> <p>3. Notwithstanding the above, the contracting authority may use a two-staged procedure to request proposals from pre-selected Bidders, if elements of the project, such as project specifications, performance indicators, financial arrangements or contractual terms cannot be described in the request for proposal document in a manner sufficiently detailed or accurate to permit the bidders to formulate their final proposals.</p> <p>4. Where a two-stage procedure is used, the following provisions apply:</p> <p>4.1.The initial request for proposals shall call upon the Bidders to submit, in the first stage of the procedure, initial proposals relating to project specifications, performance indicators, financing requirements or other characteristics</p>
--	--	---



<p>dhe karakteristikat tjera të projektit si dhe në lidhje me kushtet kryesore të kontratës të propozuara nga Autoriteti Kontraktues.</p> <p>4.2. Autoriteti Kontraktues mund të thërrasë mbledhje dhe të zhvillojë diskutime me cilindo ofertues për sqarimin e pyetjeve lidhur me kërkesën fillestare për propozim ose propozimet fillestare dhe dokumentet përcjellëse të dorëzuara nga ofertuesit. Autoriteti kontraktues përgatitë procesverbalin e çdo mbledhje ose diskutimit të këtyre, i cili duhet të përmbajë pyetjet e parashtruara dhe sqarimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues;</p> <p>4.3. pas shqyrtimit të propozimeve të pranuar, Autoriteti Kontraktues mund të shqyrtojë dhe, sipas nevojës, të ndryshojë kërkesën fillestare për propozim përmes fshirjes ose ndryshimit të cilitdo aspekt të specifikimeve fillestare të projektit, treguesve të performancës, kushteve të financimit ose karakteristikave tjera të projektit, duke përfshirë kushtet kryesore të kontratës si dhe çdo kriter për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve si dhe për përcaktimin e ofertuesit të suksesshëm të përcaktuar në kërkesën fillestare për propozime, si dhe të shtojë karakteristika ose kritere. Autoriteti kontraktues në procesverbalin e procedurës së</p>	<p>drugim karakteristikama projekta i o uslovima ugovora predlozenih od Ugovornog autoriteta.</p> <p>4.2 Ugovorni autoritet može da sazove sednicu i da razvije diskusije sa bilo kojim ponudačem da razjasni pitanja koja se tiču početnog zahteva za predloge i pratećih dokumenata podnetih od strane ponudača. Ugovorni autoritet će pripremiti zapisnik svake sednice ili diskusije, koji bi trebalo da obuhvati postavljena pitanja i data objašnjenja od strane ugovornog autoriteta;</p> <p>4.3. Nakon razmatranja primljenih predloga, Ugovorni autoritet može da razmotri i, po potrebi, izmeni početni zahtev za predloge preko brisanja ili izmena bilo kojeg aspekta početnih specifikacija projekta, indikatora performanse, finansijskih uslova i druge karakteristike projekta, uključujući i glavne uslova ugovora i svaki kriterijum ocenjivanje i uporedjivanje predloga i za određivanje najpovoljnijeg ponudača određen početnim zahtevom za predloge, i da doda karakteristike ili kriterijuma. Ugovni autoritet na zapisniku postupka selekcije treba da sadrži obrazloženje za bilo koju izmenu zahteva za predloge. Svako takvo</p>	<p>of the project as well as to the main contractual terms proposed by the Contracting Authority.</p> <p>4.2. The Contracting Authority may convene meetings and hold discussions with any of the Bidders to clarify questions concerning the initial request for proposals or the initial proposals and accompanying documents submitted by the Bidders. The Contracting Authority shall prepare minutes of any such meeting or discussion containing the questions raised and the clarifications provided by the Contracting Authority.</p> <p>4.3. Following examination of the proposals received, the Contracting Authority may review and, as appropriate, revise the initial request for proposals by deleting or modifying any aspect of the initial project specifications, performance indicators, financing requirements or other characteristics of the project, including the main contractual terms, and any criterion for evaluating and comparing proposals and for ascertaining the successful Bidder, as set forth in the initial request for proposals, as well as by adding characteristics or criteria to it. The Contracting Authority shall indicate in the record of the selection proceedings the justification for any revision to the request for</p>
--	--	--



<p>zgjedhjes duhet të përfshijë arsyetimet për çfarëdo ndryshimi të kërkesës për propozime. Çdo fshirje, ndryshim ose plotësim i këtyre duhet të theksohet në ftesën për dorëzimin e propozimeve përfundimtare;</p> <p>4.4.në fazën e dytë të procedurës, Autoriteti Kontraktues i fton ofertuesit që t'i dorëzojnë propozimet e tyre përfundimtare lidhur me një grup të vetëm të specifikimeve të projektit, treguesve të performancës ose kushteve të kontratës, sipas neneve 31 deri 38 të këtij ligji.</p>	<p>brisanje,modifikacija ili dodatak treba da se saopšti u pozivu za dostavljanje konačnih predloga;</p> <p>4.4. U drugoj fazi procedur, Ugovorni autoritet poziva ponuđače da dostave konačne predloge o jednom skupu specifikacija projekta, indikatora performanse ili uslova ugovora na osnovu člana 31 do 38 ovog Zakona.</p>	<p>proposals. Any such deletion, modification or addition shall be communicated in the invitation to submit final proposals.</p> <p>4.4.In the second stage of the proceedings, the Contracting Authority shall invite the Bidders to submit final proposals with respect to a single set of project specifications, performance indicators or contractual terms in accordance with Articles 31 to 38 of this Law.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 31</p> <p style="text-align: center;">Përmbajtja e kërkesës për propozime</p>	<p style="text-align: center;">Član 31</p> <p style="text-align: center;">Sadržaj zahteva za predloge</p>	<p style="text-align: center;">Article 31</p> <p style="text-align: center;">Content of the request for proposals</p>
<p>1. Kërkesa për propozime përmban së paku këto të dhëna:</p> <p>1.1.informatat e përgjithshme të cilat mund të kërkohen nga ofertuesit për përgatitjen dhe dorëzimin e propozimeve të tyre, duke përfshirë informatat mbi afatet për dorëzimin e propozimeve;</p> <p>1.2.specifikimet e projektit dhe treguesit e</p>	<p>1. Zahtev za predloge će sadržati najmanje sledeće podatke:</p> <p>1.1. Opšte informacije koje mogu biti potrebne ponuđačima za pripremu i podnošenje svojih predloga, uključujući i informacije o rokovima za podnošenje predloga;</p> <p>1.2. Specifikacije projekta i indikatore</p>	<p>1. The request for proposals shall include at least the following information:</p> <p>1.1.general information as may be required by the Bidders in order to prepare and submit their proposals, including information on the deadline for submission of proposals;</p> <p>1.2.project specifications and performance</p>



<p>performancës, sipas rastit, duke përfshirë kushtet e Autoritetit Kontraktues mbi standardet e sigurisë dhe sigurimit si dhe mbrojtjen e mjedisit;</p> <p>1.3.kushtet e kontratës të propozuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë një sqarim të kushteve të cilat konsiderohen të pa negociueshme;</p> <p>1.4.kriteret për vlerësimin e propozimeve, të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues për identifikimin e propozimeve të papërgjegjshme; peshën relative e cila i është dhënë secilit kriter të vlerësimit; dhe mënyrën në të cilën kriteret aplikohen për vlerësimin dhe refuzimin e propozimeve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Sigurimi i Tenderit</p> <p>1.Kërkesa për propozime duhet të përcaktojë kushtet lidhur me lëshuesin e kërkesës dhe natyrën, formën, shumën dhe kushtet e tjera themelore për sigurimin e kërkuar të tenderit.</p> <p>2. Ofertuesit mund t'i ekzekutohet sigurimi i</p>	<p>performansi, po potrebi, uključujući uslove Ugovornog autoriteta o standardima bezbednosti i bezbednosti i zaštite životne sredine;</p> <p>1.3. Uslovi ugovora predloženi od od Ugovornog autoriteta, uključujući i objašnjenje uslova koji se smatraju nepregovarački;</p> <p>1.4. Kriterijumi za ocenjivanje predloga, određenih od Ugovornog autoriteta za identifikaciju neodgovornih predloga, relativnu težinu dati svakom od kriterijuma ocenjivanja, kao i način na koji će kriterijumi primeniti za procenu i odbijanja predloga.</p> <p style="text-align: center;">Član 32 Siguracija tendera</p> <p>1. Zahtev za predloge treba da utvdi uslove u vezi izdavaoca zahteva i prirodu, formi, iznos i drugim osnovnim uslovima za potrebnu siguraciju tendera.</p> <p>2. Ponuđačima se može ekzekutirati siguracija</p>	<p>indicators, as appropriate, including the Contracting Authority's requirements regarding safety and security standards and environmental protection;</p> <p>1.3.the contractual terms proposed by the Contracting Authority, including an indication of which terms are deemed to be non-negotiable;</p> <p>1.4.criteria for evaluating proposals and for identifying non-responsive proposals; the relative weight to be accorded to each evaluation criterion; and the manner in which the criteria are to be applied in the evaluation and rejection of proposals.</p> <p style="text-align: center;">Article 32 Bid securities</p> <p>1. The request for proposals shall set forth the requirements with respect to the issuer and the nature, form, amount and other principal terms and conditions of the required bid security.</p> <p>2. A Bidder shall not forfeit any bid security</p>
--	---	---



<p>kërkuar i tenderit, vetëm në rast të:</p> <p>2.1.tërheqjes ose ndryshimit të propozimit pas skadimit të afatit për dorëzimin e propozimeve;</p> <p>2.2.mos hyrjes në negociatat përfundimtare me Autoritetin Kontraktues sipas paragrafit 1 të nenit 38 të këtij ligji;</p> <p>2.3.mos paraqitjes së ofertës së tij brenda afatit kohor të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.</p> <p>2.4.mos nënshkrimit të marrëveshjes, pasi që kjo të jetë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, pas pranimit të propozimit;</p> <p>2.5.mos ofrimit të sigurisë së kërkuar për përmbushjen e marrëveshjes pas pranimit të propozimit ose mos plotësimit të cilitdo kusht tjetër të përcaktuar në kërkesën për propozime para nënshkrimit të marrëveshjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 33</p> <p style="text-align: center;">Sqarimet dhe ndryshimet</p>	<p>osim u slučaju:</p> <p>2.1. povlačenja ili modifikacije predloga po isteku roka za podnošenje ponuda;</p> <p>2.2. Propust da se uđe u završnim pregovorima sa Ugovornim autoritetom iz stava 1 člana 38 ovog Zakona;</p> <p>2.3. Nedostavljanje njegove ponude u roku utvrđenim od strane Ugovornog autoriteta.</p> <p>2.4. Nepotpisivanja sporazuma, nakon zahteva od ugovornog autoriteta, po prijemu predloga;</p> <p>2.5. propusta da se obezbedi potrebna sigurnost za ispunjavanje sporazuma posle prijema predloga, ili neispunjenja bilo kojeg uslova naveden u zahtevu za predloge pre potpisivanja sporazuma.</p> <p style="text-align: center;">Član 33</p> <p style="text-align: center;">Objašnjenja i izmene</p>	<p>that it may have been required to provide, other than in cases of:</p> <p>2.1.withdrawal or modification of a proposal after the deadline for submission of proposals;</p> <p>2.2.failure to enter into final negotiations with the Contracting Authority pursuant to paragraph 1 of Article 38 of this law;</p> <p>2.3.failure to submit its proposal within the time limit prescribed by the Contracting Authority;</p> <p>2.4.failure to sign the Agreement, if required by the Contracting Authority to do so, after the proposal has been accepted;</p> <p>2.5.failure to provide required security for the fulfillment of the Agreement after the proposal has been accepted or to comply with any other condition prior to signing the Agreement specified in the request for proposals.</p> <p style="text-align: center;">Article 33</p> <p style="text-align: center;">Clarifications and modifications</p>
---	---	--



<p>1. Autoriteti Kontraktues mundet, me vetiniciativë ose pas kërkesës për sqarime nga një ofertues, ta shqyrtojë dhe sipas rastit ta ndryshojë cilindo element të kërkesës për propozime.</p> <p>2. Çdo ndryshim duhet tu komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve të cilët kanë pranuar kërkesën për propozime. Nëse Autoriteti Kontraktues e konsideron të nevojshme që t'i ndryshojë dokumentet dhe kur kjo bëhet pas skadimit të dy të tretave (2/3) ose më shumë të periudhës kohore për përgatitjen e ofertave, atëherë Autoriteti Kontraktues e shtyn afatin kohor për dorëzimin e ofertave për një të tretën (1/3) të periudhës fillestare.</p> <p>3. Në procesverbalin e procedurës së përzgjedhjes, Autoriteti Kontraktues duhet të paraqesë arsyetimet për çfarëdo ndryshimi të kërkesës për propozime. Të gjitha fshirjet, ndryshimet ose plotësimet e këtilla duhet tu komunikohen ofertuesve në të njëjtën mënyrë si kërkesa për propozime.</p> <p style="text-align: center;">Neni 34</p> <p style="text-align: center;">Dorëzimi i propozimeve</p>	<p>1. Ugovorni autoritet može, na sopstvenu inicijativu ili posle zahteva za pojašnjenje od ponuđača, razmotriti i po potrebi izmeniti bilo koji elemenat zahteva za predloge.</p> <p>2. Svaka izmena treba biti brzo saopštena svim kandidatima koji su primili zahtev za predloge. Ako Ugovorni autoritet smatra da je neophodno promeniti dokumente i kada se vrši nakon isteka roka od dve trećine (2 / 3) ili više vremenskog perioda za pripremu ponuda, onda Ugovorni autoritet odlaže rok za dostavljanje ponuda za jednu trećinu (1 / 3) početnog perioda.</p> <p>3. Na zapisniku procedure izbora, Ugovorni autoritet treba da dostavi obrazloženje za bilo koju izmenu zahteva za predloge. Svako takvo brisanje, izmena ili dodatak će biti saopšteno ponuđačima na isti način kao i zahtevi za podnošenje predloga.</p> <p style="text-align: center;">Član 34</p> <p style="text-align: center;">Podnošenje predloga</p>	<p>1. The Contracting Authority may, whether on its own initiative or as a result of a request for clarification by a Bidder, review and, as appropriate, revise any element of the request for proposals.</p> <p>2. Each change shall be communicated promptly to all candidates having received the request for proposals. If the contracting authority deems it necessary to change the documents, and when this is done with less than two -third (2/3) or more of the time period for the preparation of bids, then the contracting authority shall postpone the deadline for bid submission for one third (1/3) of the original period.</p> <p>3. The Contracting Authority shall indicate in the record of the selection proceedings the justification for any revision to the request for proposals. Any such deletion, modification or addition shall be communicated to the Bidders in the same manner as the request for proposals.</p> <p style="text-align: center;">Article 34</p> <p style="text-align: center;">Submission of Proposals</p>
--	--	---



<p>1. Ofertuesit e para-përzgjedhur i dorëzojnë propozimet e tyre në formë të shkruar, të nënshkruara dhe të vëna në zarfe të vulosura.</p> <p>2. Ofertuesit e para-përzgjedhur kanë të paktën dyzet (40) ditë në dispozicion nga pranimi i kërkesës për propozime për dorëzimin e propozimeve të tyre tek Autoriteti Kontraktues. Propozimi i pranuar nga Autoriteti Kontraktues pas afatit të fundit për dorëzim të propozimeve, nuk do të hapet dhe do të kthehet ofertuesit që e ka dorëzuar atë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 35</p> <p style="text-align: center;">Kriteret e vlerësimit</p> <p>1. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve teknike përfshijnë, sipas nevojës, të paktën elementet vijuese:</p> <p>1.1. saktësinë teknike;</p> <p>1.2. pajtueshmërinë me standardet mjedisore;</p>	<p>1. Seleksionirani ponuđači treba da dostave svoje predloge u pisanoj formi, potpisane i zapečaćene koverte.</p> <p>2. Seleksionirani ponuđači imaju ne manje od četrdeset (40) dana na raspolaganju od dana prijema zahteva za predloge za dostavljanje njihovih predloga Ugovornom autoritetu. Priljeni predlog od strane Ugovornog autoriteta po isteku roka za podnošenje predloga, neće se otvoriti i bit će vraćeni ponuđačima koji su ga poslali.</p> <p style="text-align: center;">Član 35</p> <p style="text-align: center;">Kriterijumi za ocenjivanje</p> <p>1. Kriterijumi za ocenjivanje i upoređivanje tehničkih predloga sadržeće najmanje sledeće:</p> <p>1.1. tehničke ispravnosti;</p> <p>1.2. usklađenost sa ekološkim standardima;</p>	<p>1. The pre-selected Bidders shall submit their proposals in writing, signed and placed in sealed envelopes.</p> <p>2. A pre-selected bidder shall have not less than forty (40) days from the receipt of the request for proposals to submit its proposal to the Contracting Authority. A proposal received by the Contracting Authority after the deadline for submission of proposals shall not be opened and shall be returned to the Bidder that submitted it.</p> <p style="text-align: center;">Article 35</p> <p style="text-align: center;">Evaluation criteria</p> <p>1. The criteria for the evaluation and comparison of the technical proposals shall include, as appropriate and without being limited to, at least the following:</p> <p>1.1. technical soundness;</p> <p>1.2. compliance with environmental standards;</p>
---	---	--



<p>1.3.realizueshmërinë operacionale dhe efikasitetin;</p> <p>1.4.cilësinë e shërbimeve dhe masat për të siguruar vazhdimësinë e tyre;</p> <p>1.5 potencialin e zhvillimit ekonomik dhe social të ofruar nga propozimet.</p> <p>2. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve financiare dhe komerciale përfshijnë, kur është e përshtatshme:</p> <p>2.1.vlerën e tanishme të tarifave të propozuara, çmimet për njësi si dhe ngarkesat tjera gjatë periudhës së marrëveshjes;</p> <p>2.2.vlerën e tanishme të pagesave të drejtpërdrejta të propozuara nga Autoriteti Kontraktues, nëse ka të tilla;</p> <p>2.3.koston për aktivitetet e dizajnit dhe ndërtimit, koston e operimit dhe mirëmbajtjes vjetore, vlerën e tanishme të koston kapitale dhe të koston së operimit dhe mirëmbajtjes;</p> <p>2.4.mbështetjen ekonomike, nëse ka të tillë, që pritet nga Autoriteti Publik;</p> <p>2.5.qëndrueshmërinë dhe zbatueshmërinë e aranzhimeve financiare të propozuara;</p>	<p>1.3. operative održivosti i efikasnosti;</p> <p>1.4. kvalitet usluga i mere da se obezbedi njihov kontinuitet;</p> <p>1.5. potencijal ekonomskog i društvenog razvoja koje nude predlozi.</p> <p>2. Kriterijumi za ocenjivanje i upoređivanje finansijskih i komercijalnih predloga će obuhvatiti, prema potrebi:</p> <p>2.1. sadašnju vrednost predloženih tarifa, cene za jedinicu i druge dažbine tokom perioda Sporazuma;</p> <p>2.2. sadašnju vrednost neposrednih isplata predloženih od strane Ugovornog autoriteta, ako postoje;</p> <p>2.3. troškove za aktivnosti projektovanja i izgradnje, troškove rada i godišnjeg održavanja, sadašnju vrednost kapitalnih troškova i troškove delovanja i održavanja;</p> <p>2.4. ekonomsku podršku, ako je ima, koja se očekuje od javnog autoriteta;</p> <p>2.5. održivost i sprovodnost predloženih finansijskih aranžmana;</p>	<p>1.3.operational feasibility and efficiency;</p> <p>1.4.quality of services and measures to ensure their continuity;</p> <p>1.5.the social and economic development potential offered by the proposals.</p> <p>2. The criteria for the evaluation and comparison of the financial and commercial proposals shall, as appropriate and without being limited to, include the following:</p> <p>2.1.the present value of the proposed tolls, unit prices and other charges over the Agreement period;</p> <p>2.2.the present value of the proposed direct payments by the Contracting Authority, if any;</p> <p>2.3.the costs for design and construction activities, annual operation and maintenance costs, present value of capital costs and operating and maintenance costs;</p> <p>2.4.the extent of economical support, if any, expected from a Public Authority;</p> <p>2.5.the soundness and viability of the proposed financial arrangements;</p>
---	---	--



<p>2.6.vlerën aktuale të tarifës së koncesionit që do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues; dhe</p> <p>2.7.potencialin e zhvillimit ekonomik dhe social të ofruar nga propozimet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36</p> <p style="text-align: center;">Krahasimi dhe vlerësimi i propozimeve</p> <p>1. Autoriteti Kontraktues krahason dhe vlerëson secilin propozim në përputhje me kriteret e vlerësimit, peshën relative të dhënë secilit prej atyre kriterëve dhe procesin e vlerësimit të përshkruar në kërkesën për propozime.</p> <p>2. Për qëllimet e lartpërmendura, Autoriteti Kontraktues mund të përcaktojë kufijtë minimal të cilësisë dhe aspekteve teknike, financiare e komerciale. Propozimet që nuk i arrijnë këta kufij minimal konsiderohen jo të përgjegjshme dhe diskualifikohen.</p> <p>3. Kur kërkesa për propozime përfshin një konkurs të projektimit, të gjitha propozimet për këtë konkurs të projektimit vlerësohen në</p>	<p>2.6. sadašnju vrednost koncesione tarife koju plaća Ugovorni autoritet i</p> <p>2.7. potencijal ekonomskog i društvenog razvoja koje nude predlozi.</p> <p style="text-align: center;">Član 36</p> <p style="text-align: center;">Poređenje i ocenjivanje predloga</p> <p>1.Ugovorni autoritet će uporediti i oceniti svaki predlog u skladu sa kriterijuma za ocenjivanje, relativnu težinu dati svakom od tih kriterijuma i proces ocenjivanja opisanih u zahtevu za predloge.</p> <p>2. Za gore navedene svrhe, Ugovorni autoritet može da odredi minimalne granice u pogledu kvaliteta i tehničke, finansijske i komercijalne aspekte Predlozi koji ne uspevaju da dostignu ove minimalne granice smatraće se neodgovornim i diskvalifikovani.</p> <p>Kada zahtev za predlog uključuje konkurs za projekcije, svi predlozi za ovaj konkurs će ocenjivati u skladu sa odgovarajućim</p>	<p>2.6.the present value of the concession fee to be paid to the Contracting Authority; and</p> <p>2.7.potential of economic and social development offered from proposals.</p> <p style="text-align: center;">Article 36</p> <p style="text-align: center;">Comparison and evaluation of proposals</p> <p>1. The Contracting Authority shall compare and evaluate each proposal in accordance with the evaluation criteria, the relative weight accorded to each such criterion and the evaluation process set forth in the request for proposals.</p> <p>2. For the purposes of above, the Contracting Authority may establish minimum thresholds with respect to quality, technical, financial and commercial aspects. Proposals that fail to achieve these minimum thresholds shall be regarded as non responsive and shall be disqualified.</p> <p>3. In the event that the request for proposals includes a design contest, any proposals with respect to design shall be evaluated in</p>
---	---	--



<p>pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit mbi Prokurimin Publik .</p> <p style="text-align: center;">Neni 37</p> <p style="text-align: center;">Vërtetimi i mëtejme i përmbushjes së kriterëve për kualifikim</p> <p>Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga cilindo ofertues që është para-përzgjedhur, për të vërtetuar sërish kualifikimet e tij në përputhje me kriteret e njëjta të përdorura gjatë para-përzgjedhjes. Autoriteti Kontraktues diskualifikon cilindo ofertues që nuk demonstroi sërish kualifikimet e tij, nëse atij i kërkohet kjo.</p> <p style="text-align: center;">Neni 38</p> <p style="text-align: center;">Negotiatat përfundimtare</p> <p>1. Autoriteti Kontraktues renditë të gjitha propozimet e përgjegjshme në bazë të kriterëve të vlerësimit, dhe fton për negociim</p>	<p>odredbama Zakona Javnoj nabavci.</p> <p style="text-align: center;">Član 37</p> <p style="text-align: center;">Dokaz ispunjavanja kvalifikacionih kriterijuma</p> <p>Ugovorni autoritet može da zahteva od svakog ponuđača koji je prethodno izabran, da ponovo pokaže svoje kvalifikacije u skladu sa istim kriterijumima korišćenim za pre-selekciju. Ugovorni autoritet može diskvalifikovati svakog ponuđača koji ne dokaže njegove kvalifikacije, ukoliko se to zahteva.</p> <p style="text-align: center;">Član 38</p> <p style="text-align: center;">Završni pregovori</p> <p>1. Ugovorni autoritet razvrstava po rangju sve predloge na osnovu kriterijuma za ocenjivanje i poziva na konačne pregovore Sporazuma</p>	<p>accordance with the relevant provisions of the Law on Public Procurement.</p> <p style="text-align: center;">Article 37</p> <p style="text-align: center;">Further demonstration of fulfillment of qualification Criteria</p> <p>The Contracting Authority may require any Bidder that has been pre-selected to demonstrate again its qualifications in accordance with the same criteria used for pre-selection. The Contracting Authority shall disqualify any Bidder that fails to demonstrate again its qualifications, if requested to do so.</p> <p style="text-align: center;">Article 38</p> <p style="text-align: center;">Final negotiations</p> <p>1.The Contracting Authority shall rank all responsive proposals on the basis of the evaluation criteria and invite for final</p>
---	--	---



<p>final të marrëveshjes ofertuesin që ka arritur klasifikimin më të mirë.</p> <p>2. Negociatat finale kanë të bëjnë vetëm me kushtet kontraktuese që janë përcaktuar si të negociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nëse ka të tilla.</p> <p>3. Nëse bëhet e qartë për Autoritetin Kontraktues që negociatat me ofertuesin e ftuar nuk do të rezultojnë në marrëveshje brenda një afati të arsyeshëm kohor Autoriteti Kontraktues informon ofertuesin për qëllimin e tij të dhënies fund negociatave dhe do ti japë ofertuesit afat prej tridhjetë (30) ditësh për të formuluar ofertën e tij. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e konsideron të pranueshëm atë propozim, do t'u jap fund negociatave me ofertuesin në fjalë dhe do të ekzekutojë garancitë korresponduese. Autoriteti Kontraktues do të ftojë më pas për negociata ofertuesit tjerë, sipas renditjes së klasifikimit të tyre, deri në arritjen e marrëveshjes apo deri në refuzimin e të gjitha propozimeve të mbetura. Autoriteti Kontraktues nuk do të rifillojë negociatat me ofertuesin me të cilin negociatat janë ndërprerë në përputhje me këtë nen .</p> <p>4. Pas përfundimit të negociatave dhe para lidhjes së marrëveshjes me ofertuesin e</p>	<p>ponuđača koji je postigao najbolje klasifikacije.</p> <p>2. Završni pregovori nemaju nikakve veze sa ugovorenim uslovima koji su definisani kao pregovarački u konačnom zahtevu za predloge, ako ih ima.</p> <p>3. Ako postane jasno za Ugovorni autoritet da pregovori sa ponuđačem neće dovesti do dogovora u razumnom roku, Ugovorni autoritet će obavestiti ponuđača o svojoj nameri da prekine pregovore i da ponuđač u roku od trideset (30) dana formuliše njegovu ponudu. Ukoliko Ugovorni autoritet ne smatra predlog prihvatljivim, onda će obustaviti pregovore sa navedenim ponuđačem i izvršiti odgovarajuće garancije. Ugovorni autoritet će zatim pozvati ostale ponuđače za pregovore, prema njihovom rangiranju, do postizanja sporazuma ili do odbacivanja svih ostalih predloga. Ugovorni autoritet neće nastaviti pregovore sa ponudjačem sa kojim su prekinuti pregovori, u skladu sa ovim stavom.</p> <p>4. Po završetku pregovora i pre sklapanja sporazuma sa preferiranim ponuđačem,</p>	<p>negotiation of the Agreement the Bidder that has attained the best rating.</p> <p>2. Final negotiations shall concern only those contractual terms, if any, that were stated as negotiable in the final request for proposals.</p> <p>3. If it becomes apparent to the Contracting Authority that the negotiations with the Bidder invited will not result in an Agreement within a reasonable timeframe, the Contracting Authority shall inform the Bidder of its intention to terminate the negotiations and give the Bidder thirty (30) days to formulate its final proposal. If the Contracting Authority does not find that proposal acceptable, it shall terminate the negotiations with the Bidder concerned and execute any corresponding guarantees. The Contracting Authority shall then invite for negotiations the other Bidders in the order of their ranking until it arrives at an Agreement or rejects all remaining proposals. The Contracting Authority shall not resume negotiations with a Bidder with which negotiations have been terminated pursuant to this paragraph.</p> <p>4. Following completion of negotiations and prior to awarding the Agreement to the</p>
---	--	---



<p>preferuar, Autoriteti Kontraktues dorëzon marrëveshjen përfundimtare në KDNM-PPP për miratim. KDNM-PPP e refuzon miratimin e marrëveshjes nëse marrëveshja dallon në masë të konsiderueshme nga projekti i miratuar nga KDNM-PPP dhe nëse marrëveshja nuk i plotëson kërkesat e ekonomicitetit dhe vlerës për paranë, nëse është e aplikueshme. Në rastet kur KDNM-PPP refuzon miratimin e marrëveshjes, Autoriteti Kontraktues nuk e lidhë marrëveshjen përkatëse. Çdo marrëveshje e cila lidhet pa miratimin e KDNM-PPP është ligjërisht e pavlefshme dhe nuk do të prodhojë efekte juridike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39</p> <p style="text-align: center;">Ndërprerja e Procedurave të Prokurimit</p> <p>1. Autoriteti Kontraktues ndërpre në aktivitetin e prokurimit para lidhjes së marrëveshjes për arsyet në vijim:</p> <p>1.1. Gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit ka më pak se dy (2) ofertues të kualifikuar;</p>	<p>Ugovorni autoritet çë dostaviti konačan sporazum za odobrenje MMUO- JPP-u. MMUO-JPP odbija odobrenje Sporazuma , ako sporazum značajno se razlikuje od odobrenog projekta od MMUO-JPP i ako sporazum ne ispunjava zahteve ekonomiciteta i vrednost za novac, ako je primenljivo. U slučajevima kada MMUO-JPP odbije odobrenje sporazuma, Ugovorni autoritet neće uči u odgovarajuće sporazume. Bilo koji sporazum koji se ugovara i posle odbijanja MMUO-JPP je pravno nevažeći.</p> <p style="text-align: center;">Član 39</p> <p style="text-align: center;">Prestanak procedura o javnim nabavkama</p> <p>1. Ugovorni autoritet çë obustaviti aktivnosti javne nabavke pre dodele sporazuma iz sledećih razloga:</p> <p>1.1. Tokom razvoja aktivnosti nabavke su primljena manje od dva (2) kvalificirana ponudaca;</p>	<p>preferred bidder, the contracting authority shall submit the final Agreement to the PPP-ISC for approval. The PPP-ISC shall decline the approval if it determined that the Agreement differs substantially from the project approved by the PPP-ISC and in any case if the Agreement to be awarded fails to meet the requirements of affordability and value-for-money, if applicable. In the event that the PPP-ISC declines the approval, the contracting authority shall not award the agreement. Any agreement awarded without the PPP-ISC's approval shall be legally invalid and shall produce no legal effects.</p> <p style="text-align: center;">Article 39</p> <p style="text-align: center;">Termination of Procurement Procedures</p> <p>1. A Contracting Authority shall terminate a procurement activity prior to the award of an Agreement for the following reasons:</p> <p>1.1. During the conduct of a procurement activity, there are less than two (2) qualified Bidders;</p>
---	---	--



<p>1.2. Të gjithë tenderët e përgjegjshëm nuk janë në pajtim me parimin e vlerës për paranë dhe nëse është e aplikueshme përballueshmëria;</p> <p>1.3. Para hapjes së kërkesave për pjesëmarrje ose propozimeve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve dhe/ose arsyeve objektive dhe të vërtetuara dhe/ose që janë jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues dhe që nuk kanë mundur të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit;</p> <p>2. Menjëherë pas ndërprerjes së aktivitetit të prokurimit, Autoriteti Kontraktues duhet të publikojë njoftimin e anulimit në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe do të përfshijë në shënimet e prokurimit një deklaratë me shkrim në të cilën parashtron arsyet faktike dhe ligjore për ndërprerjen e aktivitetit të prokurimit.</p> <p>KREU IV</p>	<p>1.2. Svi opšti tenderi koji nisu u skladu sa principom vrednost za novac i ako se sprovodi dostupacnost;</p> <p>1.3. Pre otvaranja ponude ili zahteva za učešće, prekid aktivnosti nabavke postalo je neophodno zbog događaja i/ili objektivnih i očitih razloga i/ ili su van kontrole ugovornog autoriteta i koje se nisu mogle predvideti u vreme iniciranja aktivnosti nabavke;</p> <p>2. Odmah posle prestanka aktivnosti javne nabavke, Ugovorni autoritet mora objaviti obaveštenje o otkazivanju u skladu sa odredbama ovog Zakona i uključiti u izjave nabavke pismenu deklaraciju kojoj utvrđuje činjenično i pravni osnov za prestanak aktivnosti nabavke.</p> <p>IV POGLAVLJE</p>	<p>1.2.All responsive tenders do not demonstrate value-for-money and, if applicable, affordability;</p> <p>1.3.Prior to the opening of requests to participate or proposals, the termination of the procurement activity has been made necessary due to objective and demonstrable events and/or reasons that are beyond the Contracting Authority’s control and that were not predictable at the time of the initiation of the procurement activity.</p> <p>2. Immediately upon termination of the procurement procedure, the Contracting Authority shall publish a cancellation notice in accordance with the requirements set forth in the present law and shall include in the procurement records a written statement setting forth in detail the factual reasons and the legal reasons for the termination.</p> <p>CHAPTER IV</p>
--	---	--



NEGOCIMI I MARRËVESHJEVE PA PROCEDURA KONKURRUESE	PREGOVARANJE SPORAZUMA BEZ KONKURENTNE PROCEDURE	NEGOTIATION OF AGREEMENTS WITHOUT COMPETITIVE PROCEDURES
<p style="text-align: center;">Neni 40</p> <p style="text-align: center;">Rrethanat që autorizojnë dhënien e kontratës pa procedura konkurruese</p> <p>1. Pas aprovimit nga KDNM-PPP Autoriteti Kontraktues është i autorizuar të negociojë një marrëveshje pa shfrytëzuar procedurat e përcaktuara në nenet 26 deri 39 të këtij ligji në këto raste:</p> <p>1.1. kur projekti përfshin çështje që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare;</p> <p>1.2 kur ofrimi i punëve ose shërbimeve shtesë nuk është përfshirë në marrëveshjen fillestare, por të cilat për shkak të rrethanave të paparashikuara janë bërë të nevojshme për ushtrimin e punëve ose shërbimeve të përcaktuara në marrëveshjen të cilën Autoriteti Kontraktues ia ka dhënë Partnerit Privat me kusht që marrëveshja ti jepet partnerit privat që i kryen këto punë ose shërbime:</p> <p>1.2.1. kur këto punë ose shërbime</p>	<p style="text-align: center;">Član 40</p> <p style="text-align: center;">Okolnosti koje dozvoljavaju davanje koncesije bez konkurentne procedure</p> <p>1. Posle saglasnosti MMUO-JPP Ugovorni autoritet je ovlašćen da pregovara sporazum bez korišćenja postupku iz članovima 26 do 39 ovog Zakona u ovim slučajevima:</p> <p>1.1. kada projekat obuhvata pitanja koja se odnose na nacionalnu bezbednost;</p> <p>1.2. pružaje radova ili dodatnih usluga koje nisu uključene u početni sporazum, ali koje zbog nepredviđenih okolnosti su postale neophodne za izvršavanje radova ili usluga navedenih u Sporazumu koje je Ugovorni autoritet dao privatnom partneru ,pod uslovom da se sporazum dodeli privatnom partneru koji obavlja sledeće poslove ili usluge:</p> <p>1.2.1. kada se takvi radovi ili usluge ne mogu</p>	<p style="text-align: center;">Article 40</p> <p style="text-align: center;">Circumstances authorizing award without competitive procedures</p> <p>1. Subject to approval by the PPP-ISC, a Contracting Authority is authorized to negotiate an Agreement without using the procedure set forth in Articles 26 to 39 of the present law in the following instances:</p> <p>1.1.the project involves matters pertaining to national security;</p> <p>1.2. the award of additional works or services not included in the initial Agreement but which have, through unforeseen circumstances, become necessary for the performance of the work or services described therein, which the Contracting Authority has awarded to the Private Partner, on condition that the award is made to the private partner performing such work or serviles:</p> <p>1.2.1. when such additional works or services</p>



